



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.965/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtaret: Zyhdi Haziri kryesuese, Adnan Konushevci dhe Rustem Thaqi anëtar, duke vendosur përkitazi me apelin e kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Fjoralba Kryeziu-Buzhala nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malisheve, paraqitur kundër vendimit me numër 2948-2021 i datës 03.11.2021, të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për Shpalljen e Rezultateve Përfundimtare për Zgjedhjet Lokale 2021, për Kuvendin Komunal, në seancën e panelit të mbajtur më datë 07.11.2021, mori këtë:

V E N D I M

I. Pranohet si i bazuar apeli Anr.965/2021 i datës 04.11.2021, i kandidatës për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Fjoralba Kryeziu-Buzhala nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malisheve, më të cilën ka kërkuar rinumërimin e votave në vendvotimin 3042A/02D.

II. Urdhërohet Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) që të rinumëroj vetëm fletëvotimet për Kandidat për Kuvend Komunal nga Partia Demokratike e Kosovës, në Komunën e Malishevës në vendvotimin 3042A/02D

III. Rezultati i cili del pas rinumërimit të fletëvotimeve në kutitë në Vendvotimin si në pikën -II- të këtij dispozitivi, të përfshihen në rezultatin përfundimtar.

A r s y e t i m

PZAP-i, me datë 04.11.2021, ka pranuar apelin Anr.965/2021, i paraqitur nga kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Fjoralba Kryeziu-Buzhala nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malisheve, me të cilën pretendon se në vendvotimin 3042A/02D në rezultatet përfundimtare i figurojnë vetëm 4 vota ndërsa ka 7 deklaratat e personave të cilën dëshmojnë se e kanë votuar në këtë vendvotim.

PZAP-i, pas shqyrtimit të apelit, vlerësimit të pretendimeve ankimore, vlerësimit të provave të bashkangjitura, në apel në kuptim të nenit 105 paragrafi 1, dhe nenit 117 paragrafët 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i bazuar

Nga shkresat e lëndës, rezulton fakti se kandidatja për anëtarë të Kuvendit Komunal në Komunën e Malishevës Fjoralba Kryeziu-Buzhala nga Subjekti Politik Partia Demokratike e Kosovës, me seli në Prishtinë, dega në Malisheve kërkon rinumërimin e votave në vendvotimin 3042A/02D, PZAP pas shqyrtimit të apelit erdhi në përfundim se apeli i paraqitur nga kandidatja në fjalë për rinumërimin e votave për vendvotimin e lartcekur është i bazuar pasi që në baze të kërtimeve për rezultatet përfundimtare në këtë vendvotim ka

rezultuar se kandidatja ka gjithsej 4 vota ndërsa si dëshmi ka 7 deklarata te personave qe e kane votuar ne këtë vendvotim.

Andaj ky panel, vlerëson se rinumërimi në këtë vendvotim e bënë procesin e rinumërimit të fletëvotimeve dhe shpalljen e rezultateve të saktë në kuptim të nenit 101 paragrafi 1 i LZP-së, me të cilin përcaktohet se: *“Procedura e rinumërimit të fletëvotimeve qeverisen nga objektivat e mëposhtme: saktësia, transparenca, efikasiteti, mundësia për rinumërim dhe përsëritja e zgjedhjeve dhe mbrojtja e fshehtësisë së votës”*. Nga kjo rezulton se mos procedimi i fletëvotimeve sipas dispozitës së lartë cituar, përveç cenimit të saktësisë, transparencës dhe kredibilitetit, po ashtu cenon integritetin e procesit zgjedhor dhe se pa evitimin e kësaj parregullsie, përmes rinumërimit, ky integritet dhe kredibilitet do të vihet në pikëpyetje. Për çka mbi bazën e të lartë cekurave Paneli, ka vendosur si në pikën -I- dhe -II- të dispozitivit të këtij vendimi.

Paneli me qëllim të evitimit të këtyre lëshimeve të lartë cekura dhe bazuar në nenet 115.1, dhe nenin 119.5 të LZP-së, ku parashihet se, *PZAP-i mundet që sipas vendimit të tij të shqyrtoj çështje të cilat përndryshe janë nën juridiksionin e tij kur kjo është rreptësisht e domosdoshme për të parandaluar padrejtësi serioze*, gjithashtu në mbështetje të nenit 117.4 dhe po ashtu lidhur me nenin 118 paragrafi 1 dhe 120 par. Pika d) të LZP-së, urdhëron që të bëhet rinumërimi i fletëvotimeve për vendvotimin e lartcekur duke vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Anr.965/2021 më datën 07.11.2021.**



Këshillë Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.